

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME PËRMES FONDIT TË GARANCISË SË KREDIVE RURALE””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Vazhdimi i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me qëllim kontributin e mëtejshëm në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke forcuar e thelluar marrëdhëniet ndërmjet bashkëpunimit financiar përbën qëllimin kryesor të kësaj marrëveshjeje, duke iu referuar protokollit të konsultimeve ndërqeveritare të datës 12 dhjetor 2017.

Projekti “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” ka si objektiv të inkurajojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbi një bazë të qëndrueshme, duke u dhënë mundësinë për të krijuar vende të reja pune, të rriten dhe të bëhen më konkurruese.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë për zhvillimin ekonomik të sektorit të bujqësisë, por nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Finalizimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë, në kuadrin e bashkëpunimit financiar si partnerë me Republikën Federale të Gjermanisë.

Gjithashtu, ky bashkëpunim do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, të

cilat do t'u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë, ku një sërë lehtësirash vijnë me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Ndër to përmendim faktin se shumatat e financimit nga dy marrëveshjet “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë” si dhe “Eficienca energjetike nëpërmjet sektorit bankar”, të cilat janë në proces shfuqizimi (denoncimi), mbeten në dispozicion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe, po ashtu, në një kohë të mëvonshme vendit tonë i jepet mundësia e përfitimit të financimeve të tjera nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, në kuadër të përgatitjes së projektit.

Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje paraqet interes në aspektin ekonomik dhe social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysa të mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Në Shqipëri, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë ofruesi kryesor i vendeve të punës dhe i rritjes ekonomike.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” konsiston në përdorimin e shumës së financimit me vlerë të përgjithshme prej 5 000 000 (pesë milionë) euro. Kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Premtimi i shumës së përmendur më lart do të zhvlerësohet në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në 31 dhjetor 2018.

Përfituesi do të jetë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe përfituesi final do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Për marrëveshjet financiare të mëparshme të lidhura më 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale Gjermane për projektet “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale” faza e dytë si dhe projekti “Eficienca energjetike nëpërmjet sektorit bankar”, në mbështetje të nenit 29, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe referuar shkresës nr.3452, datë 2.3.2018, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, po ndiqet paralelisht edhe procedura e denoncimit të të dyja marrëveshjeve të mëparshme. Me shkresën nr.3005, datë 22.2.2018, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, është përcjellë propozimi i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për denoncimin e dy marrëveshjeve, të cilat nuk janë zbatuar, dhe zëvendësimi i tyre me një marrëveshje të re.

Nga ana jonë është dërguar në ministritë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Financave dhe Ekonomisë shkresa për denoncimin e tyre. Pra, akti i miratimit përfundimtar të dy marrëveshjeve të mëparshme që me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së re, nuk do të veprojnë më.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji mbështet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës. Procedurat e miratimit janë në përputhje 121 të Kushtetutës, nenin 17 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe është në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”, nuk synon përafrim me *acquis* e BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Marrëveshja është e organizuar në 5 nene, me specifikimet përkatëse:

Në nenin 1 parashikohet dhënia e shumës së financimit, në vlerë të përgjithshme 5 000 000 (pesë milionë) euro, për zbatimin e projektit “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë së kredive rurale”. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë merr përsipër të mos pengojë projektin dhe të mbështesë qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë përkundrejt marrësit në rast kërkesash për rimbursim fondesh për shkak të keqpërdorimit.

Në nenin 2 shpjegohet se përdorimi i shumës së përmendur, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragraf 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në përfundim të datës 31 dhjetor 2018.

Në nenin 3 sqarohet në detaje përgjegjësia e mbulimit të taksave dhe tatimeve, konkretisht: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-

në nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahës kësaj, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Në nenin 4 shpjegohen kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve transportuese, ku specifikohet se Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht ndërmjet ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Në nenin 5, i cili është neni përmbyllës i marrëveshjes, shpjegohet koha e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, e cila përkon me ditën kur Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbyllur kushtet brenda shtetësore për hyrjen në fuqi. Paragrafi i dytë sqaron se regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102, të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Paragrafi i tretë citon afatin e pacaktuar të kësaj marrëveshjeje. Paragrafi i katërt parashikon se palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të marrëveshjes, si dhe paragrafi i fundit i nenit 5 sqaron se mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi ndërmjet palëve kontraktuese, nëpërmjet bisedave apo bisedimeve përkatëse.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- b) Fondi Rural i Garancisë së Kredive

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Dokumenti është hartuar me kontribut të:

- a) qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë;

- b) Kreditanstalt für Wiederaufbau (Kfw);
- c) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- ç) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- d) Ministrisë së Drejtësisë;
- dh) Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Projekt marrëveshja është propozuar nga Ambasada e Republikës Federale Gjermane. Marrëveshja është certifikuar dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

Pas miratimit të vendimit nr.487, datë 31.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” dhe nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse, struktura përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përgatitur projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, për t’u dërguar në ministritë e linjës për mendim dhe më pas për t’u dërguar për miratim pranë Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 17, të ligjit 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Ministria e Drejtësisë janë shprehur dakord dhe pa vërejtje.

XI RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kjo marrëveshje nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE